



Pranuar / Dorezuar Prilbena/Prodato Received/Delivered	29.03.2022	2	viti god year
Organ /Rjesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHOCK	1681/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.181/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.263/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.672/2021 të datës 01.11.2019 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi:

në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e jashtafatshme ankesa A.nr.672/2019 e datës 01.11.2019 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja, e punësuar në Bibliotekën "Hivzi Sylejmani" në pozitën "Sekretare në Bibliotekë" sipas njoftimit të datës 09.10.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër heshtjes administrative të Zyrës së personelit të Komunës së Prishtinës lidhur me kërkesën e saj të datës 13.03.2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.11.2019, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Prishtinës. Ndërsa, Këshilli pavarësisht që Komuna e Prishtinës

e ka pranuar kërkesën për përgjigje në ankesë nuk i kishte ofruar provat e kërkuara sipas obligimeve ligjore që ka.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji nga data 30.06.2021 deri më datë 05.11.2021 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa më datë 12.12.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 21.02.2022 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.263/20 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 12.12.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda afatit prej 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesit të datës 01.11.2019.

Këshilli pas përsëritjes së kërkesës për përgjigje në ankesë për të katërtën herë me radhë, Komuna e Prishtinës me datë 23.03.2022 e ka dërguar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.prot:5131/2019 të datës 01.11.2019 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimin e ankueses të datës 19.09.2019 me numër 01-112-769; Njoftimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të datës 09.10.2019; Kërkesën e datës 15.05.2019 dërguar nga Drejtori i Bibliotekës për Zyrën e Personelit; Njoftimin e Zyrës së Personelit të datës 20.05.2013; E-mailin e datës 25.01.2016 dërguar nga për E-mailin e datës 16.02.2016 dërguar nga për e harmonizimit të pozitive; E-mailin e datës 23.02.2016 dërguar nga për Përshkrimi i vendeve të punës sipas Organogramit për punonjësit e Bibliotekës i datës 08.04.2019 me numër 14/19; Përshkrimi i vendeve të punës sipas Organogramit për punonjësit e Bibliotekës i datës 28.10.2015 me numër 30/15; Statutin e Bibliotekës Komunale "Hivzi Sylejmani" i datës 31.12.2013 me numër:37/13; Dëshmi e listës së pagës e muajit maj 2000 me Code:2050-; Listën e pagave për muajin prill 2013; Listën e pagave për muajin gusht 2005; Shkresë e UNMIK-ut; Listën e të punësuarëve në Bibliotekën Hivzi Sylejmani; Ankesën e ankueses të datës 19.09.2019 të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Formularin për kërkesë apo ankesë të datës 19.09.2019; kërkesën e ankueses të datës 13.03.2019 të parashtruar në Zyrën e Personelit; Formularin për kërkesë apo ankesë të datës 13.03.2019; Vërtetimin e punësimit të ankueses i datës 18.09.2019 me numër:21/2019; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Njoftimin e datës 12.12.2019; Aktgjykimin A.nr.263/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 21.02.2022; E-mailin e datës 18.02.2020 i protokolluar me numër:375/20 dërguar nga Këshilli për menaxherin e Personelit të Komunës së Prishtinës; E-mailin e datës 07.03.2022 dërguar nga Këshilli për Menaxherin e Personelit të Komunës së Prishtinës; E-mailin e datës 22.03.2022 dërguar nga Këshilli për menaxherin e Personelit të Komunës së Prishtinës; Përgjigjen në kërkesë e dërguar nga Komuna e Prishtinës me datë 23.02.2013 me shkresat e bashkangjitura të lëndës.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa A.nr.672/2019 e datës 01.11.2019, e parashtruar nga ankuesja është e *jashtafatshme*, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me rastin e shqyrtimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka gjetur se ankuesja fillimisht me datë 13.03.2019 në Zyrën e Personelit të Komunës së Prishtinës ka parashtruar kërkesën me qëllim që titulli i vendit të punës "*Sekretare në Bibliotekë*" të rregullohet në pajtim me katalogun e vendeve të punës dhe ti bëhet "*Udhëheqëse e Sektorit të Punëve të Përgjithshme*", mirëpo për shkak të heshtjes dhe mungesës së përgjigjes në kërkesën e datës 13.03.2019 e njëjta ka parashtruar ankesë me datë 19.09.2019 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës me pretendimin për harmonizimin e koeficientit me kategorinë e nëpunësve civil të nivelit drejtues duke u bazuar në akt emërimin e saj.

Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës me datë 09.10.2019 i ka lëshuar ankueses njoftimin se me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik në pajtim me nenin 24 paragrafin 3 mund të bëni drejtpërsëdrejti ankesë në Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa ankuesja sipas udhëzimeve të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave ka parashtruar ankesë me datë 01.11.2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të heshtjes së Zyrës së personelit lidhur me trajtimin e kërkesës së saj të datës 13.03.2019.

Bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Kolegji sjell në vëmendje faktin se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. Andaj, Kolegji me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë dhe afatshmërisë së parashtrimit të ankesës, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 125 paragrafi 1 i cili përcakton se: "*Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative")*" si dhe nenit 127 paragrafi 4 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: "*Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ*", dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 01.11.2019 për shkak të heshtjes së Zyrës së Personelit në kërkesën e saj të datës 13.03.2019, është parashtruar jashtë afatit të përcaktuar për heshtje administrative sikurse është përcaktuar edhe me nenin 127 paragrafi 4 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Po ashtu, Kolegji konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, me rastin e lëshimit të njoftimit të datës 09.10.2019 duke e njoftuar ankuesen se me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik nga data 11.09.2019 ankesat mund të parashtrohen drejtpërsëdrejti në Këshill, ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi, ndërsa Kolegji me qëllim të vlerësimit të saktë të afatshmërisë së ankesës ka analizuar edhe nenin 82 paragrafi 4 Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "*Në rast të kërkesave të parashtruara gabimisht, siç parashihet me paragrafin 1 të nenit 75 të këtij Ligji, afati kundrejt parashtruesit do të vlerësohet si i respektuar nëse kërkesa është parashtruar brenda afatit (në kohe) pranë organit publik jo kompetent, ndërsa afati përkatës kundrejt organit publik kompetent do të fillojë të përlogaritet tri (3) ditë pas*

parashtrimin të kërkesës pranë organit jo kompetent", mirëpo edhe në këtë rast ankesa e ankueses e datës 19.09.2019 e parashtruar në organin jo kompetent respektivisht në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave kundër heshtjes së Zyrës së Personelit është e jashtafatshme, ngase prej momentit kur ankuesja e ka parashtruar kërkesën me datë 13.03.2019 në Zyrën e Personelit kanë kaluar më shumë se gjashtë (6) muaj.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 127 paragrafit 3 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.181/2022

Flakron GASHI

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

